



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 12 shkurt 2021
Nr. ref.:RK 1704/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

rastin nr. KI58/20

Parashtrues

Alush Kastrati

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0052, të 5 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Alush Kastrati (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Hamdi Jashari, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-15-0052, të 5 dhjetorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar), C-II-14-0074, të 29 janarit 2015.
3. Parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit më 10 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe nenin 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 prill 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 19 maj 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 8 qershor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).
9. Më 9 dhjetor 2020, Gjykata kërkoi nga DHPGJS-ja dhe parashtruesi i kërkesës që të dorëzojnë dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar.

10. Më 15 dhjetor 2020, DHPGJS-ja dorëzoi fletë-kthesën që tregon se parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar më 10 dhjetor 2019.
11. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se Ndërmarrja Shoqërore NSH “28 Nëntori” në Gjilan (ish “16 Nëntori”), ishte privatizuar më 24 mars 2006. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar në mjetet e informimit publik tri vite më vonë - më 11,12 dhe 13 qershor 2009. Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ishte data 23 prill 2011. Më 15 shkurt 2013, Kolegji i Specializuar, me Aktvendim SCEL-09-0017, e kishte shpallur të pavlefshme dhe pa efekt juridik listën përfundimtare të punëtorëve të NSH “28 Nëntori”, të publikuar me 11,12 dhe 13 qershor 2009. Gjithashtu kishte urdhëruar Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP) që të publikojë listën e re, me të cilën do të njoftoheshin të gjithë personat që kanë qenë të përfshirë në listën e publikuar me 11, 12, dhe 13 qershor 2009, po ashtu edhe të gjithë personat e përfshirë në listën që më vonë ishte aprovuar më 15 dhjetor 2010, si dhe të gjithë personat që kanë ushtruar ankesë kundër listës së publikuar. Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte rishpallur me datë 22, 23, 24 maj 2014, ndërsa afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS ishte data 14 qershor 2014.
13. Më 6 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në DHPGJS kundër AKP-së, duke kërkuar përfshirjen në listën përfundimtare të punëtorëve, për të marrë pjesën e të ardhurave nga privatizimi i NSH “28 Nëntori” në Gjilan. Parashtruesi kishte pohuar se në NSH “28 Nëntori” ka punuar nga 03.07.1980 deri 31.10.1993, kur edhe në mënyrë të kundërligjshme ishte larguar nga puna nga pushteti i atëhershëm. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kishte pohuar se pas luftës, përkatësisht nga data 19 qershor 1999 ka vazhduar punën në NSH “28 Nëntori”, deri më 23 mars 2006, gjegjësisht deri në privatizimin e ndërmarrjes. Parashtruesi i kërkesës kishte bashkangjitur si prova: (i) letërnjoftimin; (ii) librezën e punës nr. 24266/78, data e fillimit 03.07.1980 deri 31.10.1993; dhe, (iii) Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan të datës 30.04.1993.
14. Gjykata vëren se nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në DHPGJS, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan të 30 prillit 1993, që sipas parashtruesit të kërkesës, i ka njohur atij fitimin e humbur deri më 31 tetor 1993. Gjykata po ashtu vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan nuk i është bashkangjitur kërkesës nr. KI58/20. Rrjedhimisht, për Gjykatën është e panjohur përmbajtja e saktë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan të 30 prillit 1993.
15. Më 1 korrik 2014, AKP-ja kishte dorëzuar përgjigje me shkrim duke pohuar se ankesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar, pasi që i njëjti në kohën e privatizimit më 24 mars 2006 nuk ishte i regjistruar si punëtor i NSH “28 Nëntori”, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e

punëtorëve me të drejta legjitime siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, neni 10.4. AKP-ja, po ashtu, kishte pohuar se dokumentet e prezantuara nga parashtruesi i kërkesës nuk janë bazë e mjaftueshme për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime, sepse nga librezja e punës shihet se parashtruesi i kërkesës ka punuar deri më 31.10.1993, mirëpo nuk ka prezantuar ndonjë provë tjetër materiale që vërteton “kontinuitetin” e marrëdhënies së punës pas vitit 1999.

16. Më 29 janar 2015, Kolegji i Specializuar, me Aktgjykim C-II-14-0074, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Kolegji i Specializuar, duke u bazuar në librezën e punës, kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës ka ndërprerë marrëdhënien e punës më 31.10.1993 në NSH “28 Nëntori” në Gjilan. Prandaj, Kolegji i Specializuar konstatoi që nga provat e disponuara rezulton se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret e nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe, si e tillë, duhet të refuzohet si e pabazuar. Kolegji i Specializuar po ashtu përcaktoi se kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë brenda 21 ditësh, tek Kolegji i Apelit.
17. Më 30 mars 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Kolegjin e Apelit, kundër aktgjyqimit të lartpërmendur të Kolegjit të Specializuar, duke pretenduar si ai vendim është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës kishte argumentuar se: (i) ka prezantuar librezën e punës me të cilën marrëdhënia e punës figuron e mbyllur më 31.10.1993, mirëpo ai kishte pohuar se ka bashkangjitur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, të 31.10.1993, me të cilin parashtruesit të kërkesës i ishte njohur fitimi i humbur deri më 31.10.1993; (ii) ai ka punuar gjatë vitit 1993 deri në qershor, gjegjësisht “para konfliktit të armatosur” në Kosovë dhe si punëtorë i etnisë shqiptare ka qenë i diskriminuar nga menaxhmenti i atëhershëm; (iii) pas vitit 1999 kishte punuar shumë vite me radhë në NSH “28 Nëntori” në Gjilan. Duke u mbështetur në këto argumente, parashtruesi kërkonte që të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve me të drejta në 20% të të ardhurave pas privatizimit dhe shitjes të NSH “28 Nëntori” në Gjilan.
18. AKP-ja nuk kishte dorëzuar përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit të kërkesës.
19. Më 5 dhjetor 2019, Kolegji i Apelit, me Aktgjykim AC-I-15-0052, vendosi që ankesa e parashtruesit të kërkesës të hedhet poshtë si e papranueshme. Kolegji i Apelit kishte arsyetuar si në vijim: *“Sa i përket këtij ankuesi Kolegji i Apelit vlerëson se e njëjta është paraqitur jashtë afatit të paraparë ligjor. Nga shkresat e lëndës përkatësisht nga flet-kthesa me të cilën është pranuar aktgjykimi i atakuar, Kolegji i Apelit vërteton faktin se aktgjykimi C-II-14-0074-C72 është pranuar nga ana e ankuesit me datë 28 shkurt 2015 dhe sipas këshillës juridike të të njëjtit vendim është paraparë se mund të ushtrohet ankesa në afat prej 21 ditësh. Ne rastin konkret ankuesi ka pasur të drejtë të parashtrojë ankesë deri me datë 21 mars 2015, ndërsa ankesa është parashtruar përmes postës rekomande me datë 27 mars 2015 dhe ka arritur në gjykatë me datë 30 mars 2015, që i bie se është parashtruar 6 (gjashtë) ditë*

jashtë afatit të paraparë ligjor. Kolegji i Apelit ankesën e parashtruar të ankuesit e hedh poshtë si të pa afatshme, në bazë të nenit 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
21. Në këtë vazhdë, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Ky aktgjykim është nxjerrë me shkelje të nenit 31, 32 dhe 54, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pasi që në rastin konkret, kur shkalla e parë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ia ka dorëzuar aktgjykimin C-II-14-0074, të datës 29.01.2015, të njëjtin ia ka dorëzuar një personi tjetër nga po i njëjti fshat, i cili për kohëzgjatje mbanë emrin dhe mbiemrin e njëjtë me ankuesin Alush (Selver)Kastrati.”*
22. Më tej, parashtruesi i kërkesës argumenton se: *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimin C-II-14-0074, të datës 29.01.2015, ia ka dorëzuar AMK me datën 28.02.2015 dhe i njëjti pasi që e ka vërejtur se nuk ka interes për atë çështje, pas shumë ditësh, me saktësisht me datën 25.03.2015, këtë aktgjykim së bashku me zarfin ia ka dërguar Alush (Selver) Kastratit, i cili me datën 26 mars 2015 e ka përpiluar ankesën, ndërsa me datën 27 mars 2015, e ka dorëzuar në postë, në adresën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në aktgjykimin të cilin po e atakojmë, arsyetimi i gjykatës është se Alush Kastrati i është dorëzuar aktgjykimi i shkallës së parë me datën 28 shkurt 2015 dhe afati për ankesë ka qenë deri me datën 1 mars 2015, ndërsa ankuesi Alush Kastrati ka ushtruar ankesë me datën 27 mars 2015, që i bie 6 ditë pas kalimit të afatit ligjorë. Mirëpo, e tërë kjo ka ndodhur për faktin që posta gabimisht ia ka dorëzuar aktgjykimin e shkallës së parë një AMK, i cili është nga i njëjti fshat dhe mbanë emrin e mbiemrin e njëjtë me ankuesin dhe ky fakt vërtetohet nga "Deklarata nën betim", me numër LRP. nr. rendor.: 727/2020, të datës 06.02.2020, e dhënë pranë noterit HM në Gjilan, nga AMK, në të cilën shumë kuartë vërtetohet se aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar AMK.”*
23. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës po ashtu ka dorëzuar në Gjykatë deklaratën e noterizuar, të 6 shkurtit 2020, të personit AMK ku ka deklaruar se ai ka pranuar Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar [C-II-14-0074], të 29 janarit 2015, në vend të parashtruesit të kërkesës.

24. Parashtruesi i kërkesës pohon se Kolegji i Apelit nuk ka vlerësuar drejtë se kush ka pranuar aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar, sepse në mënyrë “sipërfaqësore” ka hedhur poshtë ankesën e tij për shkak të kalimit të afatit prej 21 ditësh.
25. Parashtruesi i kërkesës rithekson se vendimi i kontestuar i Kolegjit të Specializuar është dashur t’i dorëzohet atij personalisht apo familjarit të tij, porse pa fajin e tij ai vendim i është dorëzuar bashkëfshatarit që mban të njëjtin emër. Parashtruesi i kërkesës shton se nuk është faji apo përgjegjësia e tij përse vendimi i kontestuar i Kolegjit të Specializuar i është dorëzuar personit tjetër me të njëjtin emër dhe se për këtë shkak atij i janë cenuar të drejtat themelore të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës.
26. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0052, të 5 dhjetorit 2019 dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim tek e njëjta gjykatë, “duke e këshilluar për evitimin e këtyre të metave të pa verifikuara më herët.”

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 13

Zgjatja e afateve të dhëna kohore

Çdo kolegji, nën-kolegji apo gjyqtar i vetëm, por vetëm në rrethana tejet të jashtëzakonshme, si dhe vetëm për arsye shumë të bazuara, mund të zgjasë afatet kohore apo periudhat e përcaktuara me këtë ligj apo në shtojcën e tij, për aq kohë sa konsiderohet e arsyeshme brenda rrethanave.

Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 21

Kalimi i periudhave kohore

1. Pa paragjykuar përgjegjësitë e veta për të trajtuar çështjet që i parashtrohen në mënyrë të shpejtë, Dhoma e Posaçme, në raste të veçanta dhe kur është në interesin e drejtësisë, mund të vazhdojë afatin e paraparë me ligj apo me këtë Shtojcë, nëse me arsye konstaton se nuk është praktike për palën apo Dhomën e Posaçme që të zgjidhin çështjen në fjalë brenda afatit kohor të paraparë me ligj apo këtë Shtojcë.

2. Nëse pala kërkon zgjatjen e afatit kohor, ajo palë dorëzon një kërkesë për zgjatje të afatit para kalimit të afatit përkatës kohor. Kryesuesi i Kolegjit mund të miratojë zgjatjen nëse kërkesa parashtron rrethanat dhe arsyet të cilat Kryesuesi i kolegjit i konsideron të mjaftueshme për të lejuar zgjatjen, si dhe nëse Kryesuesi i Kolegjit përcakton që asnjë palë nuk i nënshtrohet ndonjë paragjykimi serioz me atë zgjatje.

3. Pala parashtron kërkesën për zgjatje posa të bëhet e vetëdijshme për rrethanat dhe arsyet të cilat ajo palë beson që arsyetojnë zgjatjen. Në asnjë rast, kërkesa nuk mund të parashtrohet pas kalimit të afatit kohor së përcaktuar. Njëkohësisht me parashtrimin e kërkesës, pala i dorëzon gjitha palëve tjera një kopje të asaj kërkesë:

4. Kryesuesi i Kolegjit mund të miratojë zgjatjen vetëm për aq kohë për sa kërkojnë rrethanat e paraqitura me kërkesë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

28. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parashikon:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

31. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës është se Kolegji i Apelit është dashur ta shqyrtojë në merita ankesën e tij, të 30 marsit 2015, duke marrë parasysh se aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar i ishte dorëzuar personit AKM që mban të njëjtin emër. Parashtruesi i kërkesës argumenton se për shkak të mos shqyrtimit në merita të ankesës së tij, Kolegji i Apelit ka shkelur të drejtat themelore të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës.
32. Në dritën e fakteve të rastit, pretendimeve të parashtruesit, si dhe sfondit të lartcekur ligjor, Gjykata vë theksin në rregullin për shterimin e mjeteve juridike, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës. Në këtë vazhdë, Gjykata vë në pah se kërkesa për shterimin e mjeteve juridike detyron personat që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion, pranë gjykatave të rregullta kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
33. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të parandalojnë apo të korrigjojnë shkeljet kushtetuese, përmes procedurave gjyqësore të rregullta, para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta, në lidhje me shkeljet e pretenduara të Kushtetutës, gjegjësisht të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/20, *Parashtrues Lutfi Shantir*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 korrikut 2020, paragrafi 36; po ashtu, shih rastin e GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
34. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike derivon nga parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit mekanizmi mbrojtës në Gjykatën Kushtetuese është i karakterit subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih KI19/20 *Parashtrues Lutfi Shantir*, cituar më lart, paragrafi 37; dhe po ashtu shih rastin e GJEDNJ-së, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).
35. Pra, arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të gjyqësisë kushtetuese (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI116/14, *Fadil Selmanaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 26 janarit 2015, paragrafi 48 dhe nr. KI118/15 *Parashtrues Dragiša Stojković*, Aktvendim për Papranueshmëri i 12 prillit 2016, paragrafi 38).
36. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë qasje në mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi procedurale për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih rastet e

GJEDNJ-së, *Vernillo kundër Francës*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27 dhe *Dalia kundër Francës*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 38).

37. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se nuk ka asnjë provë që parashtruesi i kërkesës ka kërkuar zgjatjen e afatit për paraqitje të ankesës (apo që në përgjithësi ka njoftuar Kolegjin e Apelit për rrethanat që ia kanë pamundësuar parashtrimin e ankesës brenda afatit ligjor), në pajtim me nenet 13 dhe 21 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Gjykata Kushtetuese – në pajtim me parimin e subsidiaritetit – nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa qenë paraprakisht e ngritur dhe vlerësuar në procedurë pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI89/15, *parashtrues Fatmir Koci*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 35 dhe KI01/19 *parashtrues Fatos Rizvanolli*, Aktvendim për Papranueshmëri i 2 shtatorit 2020, paragrafi 99).
38. Gjykata rithekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë pranë gjykatave të rregullta, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të nisë procedura pranë gjykatave të rregullta për shkeljet e pretenduara (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI24/16 *Parashtrues Avdi Haziri*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 nëntorit 2016, paragrafi 39 dhe referencat e përmendura aty).
39. Gjykata vëren se në praktikën gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, parashtruesit nuk lirohen nga detyrimi për ngritje të çështjeve tek gjykatat vendore, madje edhe në rastet kur gjykatat vendore kanë mundësi apo janë të obliguara ta shqyrtojnë rastin me vetë-iniciativë (*own motion*), në lidhje më të drejtat e mbrojtura me KEDNJ (shih rastet e GJEDNJ-së, *Van Oosterwijk kundër Belgjikës*, Aktgjykim lidhur me mos shterim të mjeteve juridike i 6 nëntorit 1980 dhe *Gaziyev kundër Azerbaixhanit*, Vendim i Pjesshëm për Pranueshmëri i 8 shkurtit 2007).
40. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që në procedurën ankimore në Kolegj të Apelit ta dorëzojë deklaratën e noterizuar të personit AMK, si provë për zgjatjen e afatit dhe shqyrtim merititor të ankesës së tij. Parashtruesi i kërkesës këtë pretendim dhe deklaratën e noterizuar i ngre dhe dorëzon për herë të parë në këtë Gjykatën Kushtetuese, - edhe përkundër faktit se ka pasur mundësi që të njëjtën ta paraqesë në Kolegj të Apelit (pra të kërkojë zgjatjen e afatit të ankesës), në pajtim me nenet 13 dhe 21 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
41. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme, pasi që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi